



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:284852

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05460092

**P.nr.136/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË**, përmes gjyqtarit Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të pandehurit L. I. nga ....., për shkak të veprës penale: kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-ës, në Gjilan, PP.II.nr.1872/2023, të datës 12.12.2023, duke vendosur sipas kërkesës së PTH-së në Gjilan, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor, më datë 15.03.2024, hartoi dhe publikoi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-ës nga Gjilani PP.II.nr.1872/2023, të datës 12.12.2023, për dhënien e Urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit,

**L. I.**, me pseudonimin L., nga babai D., nëna Sh., e gjinisë B., i lindur me datë ..... në ....., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të ekonomike mesatare, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **Ë s h t ë f a j t o r**

Me datë 29.11.2023, rreth orës 16:40 minuta, në ..... Njësi i Task Forcës –DRK Lindja Kaçanik, pas kontrollit në podrumin e shtëpisë së të pandehurit L. I. kishin gjetur 330 copë sinfona (mbledhës uji për banjo) dhe 36 copë fontana (rezervar uji) për guaca të banjës WC, pasi që gjatë implementimit të planit operativ për luftimin e kontrabandës në brezin kufitar Kosovë – Serbi, kishin vërejtur duke lëvizur rrugëve ilegale nga drejtimi i fshatit Ternoc i Madh Bujanocit të Republikës së Serbisë, në drejtim të fshatit Hodonoc Republika e

Kosovës një ..... të markës ..... ngjyrë e ....., me ç' rast i pandehuri kishte arritur që ta shkarkonte mallin në vendin e lartcekur dhe për të cilin mall i pandehuri nuk posedonte dokumentacion për prejardhjen e tij, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij me qëllim të shmangies të kontrollit doganor, ka bërë bartjen e mallit përmes rrugëve ilegale – malore nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës që sipas vlerësimit të Doganës së Kosovës, shuma e detyrimeve doganore është 154 euro e 30 cent;

- me çka ka kryer veprën penale, kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-ës, si dhe nenit 364 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurin L.I. e,

## **G J Y K O N**

Me dënim me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, të cilën gjobë i pandehuri ka për ta arkëtuar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën, nëse i pandehuri nuk e arkëton dënimin me gjobë në afatin prej 15 ditëve, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burg, ashtu që çdo ditë burgu do t'i llogaritet në shumë prej 20 €.

Në kuptim të nenit 311, paragrafi 6 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohen 330 copë sinfona (mbledhës uji për banjo) dhe 36 copë fontana (rezervar uji) për guaca të banjos WC i sekuestruar sipas Urdhërësës për sekuestrimin e përkohshëm të mallit PN.nr.16/2023, të datës 10.01.2024.

Pala e dëmtuar Doga e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor ta arkëtoj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Gjithashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të përgjithshme, më datën 19.12.2023, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1872/2023, kundër të pandehurit L. I., nga ..... për shkak të veprës penale: kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK-së, ndaj të cilit ka paraqitur edhe kërkesën për dhënien e Urdhrit ndëshkimor dhe ka kërkuar që të pandehurit të i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 493 parag. 2 të KPPRK-së.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi aktakuzën, Kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës dhe konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e PTH-së, për dhënien e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në aktin e akuzës siç janë: Raporti fillestar i incidentit me nr. 2023-YED-067, i datës 29.11.2023, Kërkesa për sekuestrim të përkohshëm të mallit 2023-YED-067, Raporti i Doganës për vlerësimin e mallit, formulari për pranimit dorëzim të rastit, informacionet e personit nga data baza e policisë për të pandehurin, vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të mallit 2023-YED-067, deklaratat e të pandehurit L. I. e datës 29.11.2023, foto dokumentacion nga vendi i ngjarjes, raporti i oficerit V. D., raporti i oficerit A. K., si dhe shkresat tjera në lëndë, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me bindje se edhe ky dënim i shqiptuar do të ndikojë tek i pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, prandaj e aprovoi kërkesën e PTH-së nga Gjilani, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë.

Në kuptim të nenit 311, paragrafi 6 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohen 330 copë sinfona (mbledhës uji për banjo) dhe 36 copë fontana (rezervar uji) për guaca të banjos WC i sekuestruar sipas Urdhresës për sekuestrimin e përkohshëm të mallit PN.nr.16/2023, të datës 10.01.2024.

Pala e dëmtuar Doga e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, e në pajtim me dispozitat e nenit 452 lidhur me nenin 449, paragrafi 2, pika 2.6 e KPPRK-së, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro) si dhe shumën prej 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Nga të cekurat e më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:284852, 15.03.2024**

**Gjyqtari,**

---

Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi- urdhrin ndëshkimor mundë të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, kundërshtimi i paraqitet kësaj gjykate, e pastaj gjykata do të caktoj seancën për shqyrtim kryesor në pajtim me nenin 496 parag. 4 i KPPRK-së.